**Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"**
**Fakulteti i Arteve**

**SYLLABUS**
*Lënda:* **Arti dhe Shoqëria**

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Arteve |
| Titulli i lëndës: | Arti dhe Shoqëria |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | IV |
| Numri i orëve në javë: | 2 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 2+2 |
| Koha/lokacioni i ligjëratave: | E Premte, ora 11:00 |
| Koha/lokacioni i ushtrimeve: | |
| Mësimdhënës të lëndës: | Prof.Ass.Dr. Mexhit Shaqiri |
| Detajet kontaktuese: | Email: mexhit.shaqiri@uni-pr.edu |
| | |
| Përshkrimi i lëndës | *Arti dhe Shoqëria është një fushë studimore, e cila bën pjesë në kuadrin e përgjithshëm të sociologjisë së kulturës. Fokusi i saj kryesor është hulumtimi i marrëdhënieve komplekse midis arteve, strukturave dhe institucioneve shoqërore. Këto marrëdhënie gjithmonë manifestohen përmes një interaksioni dinamik, në të cilin artet dhe shoqëria influencojnë njëra-tjetrën.<br>Lënda Arti dhe Shoqëria trajton zhvillimin e Arteve të Bukura dhe marrëdhëniet e tij me dukuritë dhe proceset sociale, politike, dhe strukturat ekonomike të kulturave bashkëkohore dhe historike. Ky kurs u ofron studentëve një hyrje në teoritë dhe debatet themelore në sociologjinë e artit, duke përdorur ekstrakte nga autorët kryesorë bashkëkohorë dhe më me ndikim në këtë fushë. Ky kurs hap një dialog produktiv ndërdisiplinor midis sociologjisë dhe historisë së artit si dhe ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të çështjes.* |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi kryesor i lëndës është të pajisë studentët me njohuritë bazike që kanë të bëjnë me artin dhe shoqërinë, duke u fokusuar në disa pjesë kryesore, si:<br>– teoria klasike sociologjike dhe sociologjia e artit<br>– prodhimi social i artit<br>– sociologjia e artistit |

| | |
|---|---|
| | – muzetë dhe ndërtimi social i kulturës së lartë<br>– sociologjia, forma estetike dhe specifika e artit. |
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | *Përmes hulumtimit, diskutimeve dhe prezantimeve të disa rasteve studimore në praktikat e artit historik dhe bashkëkohor, studentët do të zhvillojnë mendimin e tyre kritik për marrëdhëniet ndërdisiplinore në midis sociologjisë dhe historisë së artit.*<br>*Studentët do të zhvillojnë të kuptuarit e tyre rreth çështjeve të rëndësishme bashkëkohore dhe historike mbi artin si dhe të eksplorojnë lidhjen dhe marrëdhëniet e tyre me Artet e Bukura.*<br>*Zotërimi i koncepteve bazë mbi artin dhe shoqërinë.* |

**Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithësej** |
|---|---|---|---|
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | | | |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 10 | 10 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 2 | 2 / 2 | 4 |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 20 / 10 | 20 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 1 | 14 / 2 | 21 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | | | |
| Projektet,prezantimet ,etj | 1 | 15 / 15 | 15 |
| **Totali** | | | **100:25 = 4 ECTS** |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | *Metodologjia e aplikuar gjatë ligjërimit të lëndës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:*<br>*Metodën interaktive, punimet më shkrim, projektet hulumtuese duke përfshi punën individuale dhe atë në grupe,prezantimet e ndryshme, debatet, etj.* |
| **Metodat e vlerësimit:** | *Vlerësimi i studentëve do të bëhet përmes dy kolekfiumeve të rregullta, punimeve të ndryshme dhe prezantimeve si dhe provimit final.* |
| **Literatura** | |
| **Literatura bazë:** | 1. Jeremy Tanner, *TheSociologyofArt:AReader*, Routledge Taylor & Francis Group, 2004.<br>*2.* Matei Calinescu, *Pesë ftyrat e modernitetit,. Shtetpi Botuese DITURIA, Tiranë.* |

| | |
|---|---|
| | 3. Judith N. Martin, Thomas K. Nakayama, *Hyrje në komunikimin ndërkulturor*, UET Press, Tiranë, 2010. |
| **Literatura shtesë:** | 1. Jean-Francois Braunstein, Bernard Phan, Manual i Kulturës së Përgjithshme.<br>2. Zyhdi Dervishi, *Sociologji kulture* I, Tiranë, 2001.<br>*3.* Umberto Eco, *Historia e bukurisë*, Dituria, 2011. |

| **Plani i dizejnuar i mësimit:** | |
|---|---|
| **Java** | **Ligjërata që do të zhvillohet** |
| ***Java e parë:*** | Njoftimi i studentëve me planprogramin e lëndës |
| ***Java e dytë:*** | – Sociologjia dhe Historia e Artit |
| ***Java e tretë*:** | **Teoritë klasike sociologjike dhe sociologjia e artit** |
| ***Java e katërt:*** | **Karl Marksi:**<br>– Marksizmi dhe historia e artit<br>– Qenia sociale dhe vetëdija shoqërore<br>– Arti dhe ideologjia<br>– Zhvillimi historik dhe traditat kulturore |
| ***Java e pestë:*** | **Max Weber**<br>– Arti dhe racionalizimi kulturor<br>– Feja magjike, feja e shpëtimit dhe<br>– evolucioni i artit<br>– Tensionet ndërmjet artit dhe fesë etike<br>– Arti dhe racionalizmi në botën perëndimore |
| ***Java e gjashtë*:** | **Georg Simmel**<br>– Simetria dhe organizimi shoqëror<br>– Përmbajtja<br>**Emile Durkheim**<br>– Struktura sociale, kultura materiale dhe<br>– komunikimi simbolik<br>– Kuptimi simbolik dhe objektivizimi<br>– Objektet simbolike, ndërveprimi komunikues dhe<br>– krijimtaria sociale |
| ***Java e shtatë:*** | **Prodhimi social i artit:**<br>– Raymond Williams<br>– Howard S. Becker<br>– Pierre Bourdieu |
| ***Java e tetë:*** | **Sociologjia e artistit:**<br>**Arnold Hauser**<br>– Statusi social i artistit të Renesansës |
| ***Java e nëntë:*** | **Sociologjia e artistit:**<br>**Natalie Heinich**<br>– Efekti Van Gog<br>**Norbert Elias**<br>– Arti i zejtarëve dhe arti i artistëve |

| | |
|---|---|
| | **David Brain**<br>– Faktori material dhe arti i artefakteve |
| ***Java e dhjetë:*** | **Muzetë dhe ndërtimi shoqëror i kulturës së lartë:**<br>**Jürgen Habermas**<br>– Kritika e artit dhe institucionet e sferës publike<br>**Pierre Bourdieu**<br>Përvijimi i një teorie sociologjike të perceptimit të artit |
| ***Java e njëmbëdhjetë*:** | **Muzetë dhe ndërtimi shoqëror i kulturës së lartë:**<br>**Paul DiMaggio**<br>– Sipërmarrja kulturore në Bostonin e shekullit të nëntëmbëdhjetë: krijimi i një baze organizative për kulturën e lartë në Amerikë.<br>**Vera L. Zolberg**<br>Vizione kontradiktore në muzetë e artit amerikan |
| ***Java e dymbëdhjetë*:** | – **Sociologjia, forma estetike dhe specifika e artit** |
| ***Java e trembëdhjetë*:** | **Karl Mannheim**<br>Dinamika e realiteteve shpirtërore |
| ***Java e katërmbëdhjetë*:** | **Robert Witkin**<br>– Van Eyck përmes xhamit zmadhues |
| ***Java e pesëmbëdhjetë*:** | **Talcott Parsons**<br>**Arti si simbolikë shprehëse: teoria e veprimit dhe sociologjia e artit:**<br>– Simbolika shprehëse dhe ndërveprimi shoqëror.<br>– Shtjellimi kulturor i kuptimeve shprehëse dhe evolucioni i artit. |

| **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:** |
|---|
| *Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes prezantohen në çdo fillim viti shkollor nga ana e mësimdhënësit, poashtu këtu përfshihen edhe kriteret për vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrimeve.*<br>*Rregullat e mirësjelljes kërkojnë mbajtjen e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, respektimi i orarit,etj.*<br>*Ndërsa kriteret vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrimeve kërkojnë që studenti t'i përmbahet orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve, etj.* Kontakti me profesorin apo asistentin e lëndës mund të zhvillohet gjatë orëve të konsultimeve ose përmes emailit zyrtar. |